

**UNHCR**United Nations High Commissioner for Refugees
Haut Commissariat des Nations Unies pour les réfugiés

Data: 11 shkurt 2019

FTESË PËR OFERTË

SHËRBIME TË SIGURIMIT PËR ZYRAT E UNHCR-së NË KOSOVË

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) në Kosovë fton të gjitha kompanitë e interesuara për të bërë ofertë për ofrimin e shërbimeve si më poshtë për zyren e UNHCR-së;

Numri i referencës: ITB/2020/01

- Ofrim i shërbimeve të sigurimit

Detajet për shërbimet e kërkuara, Termat e Referencës dhe Formularin e Regjistrimit të UNHCR-së mund ta kërkontë me e-mail në adresën kega@unhcr.org. Në e-mailin tuaj, në hapësirën subjekti, ju lutem shënoni numrin e referencës të ITB-së për ofertën që po bëni.

Dorëzimi i ofertës:

Ofertat duhet të mbajnë logon zyrtare, duke identifikuar qartë kompaninë tuaj.

Kompanitë e interesuara duhet të jenë të regjistruara në Kosovë dhe me rastin e ofertimit duhet të aplikojnë sistemin e dy zarfave, atë të ofertimit teknik dhe atij financiar, të cilat dorëzohen në një zarf të tretë të mbyllur.

Zarfi i tretë (i jashtëm) duhet të përmbajë dy zarfat të brendshëm siç përshkruhet më poshtë:

- Zarfi i parë i brendshëm duhet të përmbajë **"Pjesën Teknike"** dhe të përmbajë komponentën e plotë teknike të ofertës tuaj.
- Zarfi i dytë i brendshëm duhet të përmbajë **"Pjesën financiare"** dhe të përmbajë komponentën financiare të ofertës tuaj, e cila duhet nëshkruar dhe vulosur.
- Të dy zarfat e brendshëm duhet të kenë të shkruar emrin dhe adresën e kompanisë tuaj.

Dokumentat e kompletuara duhet të dorëzohen në zyren e UNHCR-së në adresën si më poshtë, më së voni deri në ditën e **mërkure, 11 mars 2020, ora 11:00**.

Adresa:

UNHCR, Zyra e shefit të misionit
Rr. Lorenc Antoni nr.26 (Pejton),
10000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: 038 241 509